

Emërtimi i lëndës		<b>Kalkulus 1</b>		<b>KODI MAT 154</b>
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		<b>Disiplina e formimit të përgjithshëm</b>		
Përshkrimi		Programi synon të japë një studim të plotë të funksionit duke trajtuar bashkësinë e tij të përcaktimit, çiftësinë, monotoninë dhe ekstremumet duke vazhduar më tej me limitin e funksionit, vazhdueshmërinë e tij, diferencimin dhe integrimin e funksionit të një variabli, rregullat e derivimit dhe aplikime të derivatit, format e pacaktuara dhe rregulli i l'Hopital-it, etj.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	125 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
Format e mësimdhënies	Leksione	-	45	-
	Ushtrime	-	30	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik  45 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Funksionet dhe modelet matematike.</li> <li>2. Ekuacionet jo-lineare</li> <li>3. Funksionet monotone, funksionet rritës dhe funksionet zbritës. Diferencimi</li> <li>4. Disa klasa të rëndësishme funksionesh.</li> <li>5. Transformimet dhe kombinimet e funksioneve.</li> <li>6. Funksionet inverse.</li> <li>7. Përsëritje.</li> <li>8. Problemi i tangjentes dhe shpejtësisë.</li> <li>9. Limiti i funksionit .</li> <li>10. Limitet e njëanshme dhe limitet e pafundëm.</li> <li>11. Përkufizimi i saktë i limitit.</li> <li>12. Rregullat e kalimit në limit .</li> <li>13. Përsëritje</li> <li>14. Vazhdueshmëria.</li> <li>15. Limitet në pikat e pafundme.</li> <li>16. Limitet e pafundme në pikat e pafundme.</li> <li>17. Tangjentet, shpejtësitë, dhe raportet e tjera të ndryshimit.</li> <li>18. Përkufizimi i derivatit.</li> <li>19. Interpretimi i derivatit si raport ndryshimi .</li> <li>20. Derivati i një funksioni .</li> <li>21. Derivatet e funksioneve elementare</li> <li>22. Funksionet exponenciale.</li> <li>23. Rregullat e derivimit</li> <li>24. Rregulla të tjera të derivimit</li> <li>25. Derivimi i funksioneve trigonometrike.</li> <li>26. Derivimi i funksionit të përbërë, rregulli zinxhir.</li> <li>27. Derivimi në mënyrë implicite</li> <li>28. Derivatet e rendeve të larta .</li> <li>29. Përafrimet lineare dhe diferencialet.</li> <li>30. Vlerat maksimum dhe minimum .</li> <li>31. Teorema e vlerës së mesme.</li> <li>32. Përcaktimi i grafikut nëpërmjet derivatit</li> </ol>		

	<ol style="list-style-type: none"><li>33. Format e pacaktuara, rregulli i L'Hopital-it</li><li>34. Studimi i plotë i një funksioni nëpërmjet derivateve.</li><li>35. Problemet e optimizimit .</li><li>36. Metoda e përafritimit e Njutonit .</li><li>37. Antiderivatet</li><li>38. Sipërfaqet dhe distancat</li><li>39. Integrali i caktuar</li><li>40. Teorema themelore e kalkulusit.</li><li>41. Integralet e pacaktuara.</li><li>42. Tabela e integraleve.</li><li>43. Përsëritje.</li><li>44. Metoda e zëvendësimit.</li><li>45. Logaritmi i përcaktuar si integral.</li></ol>
--	--

Emërtimi i lëndës		Fizikë		KODI (161)
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplina e formimit të përgjithshëm		
Përshkrimi		Ky kurs ofrohet për studentët e degës së biologjisë dhe paraqet në mënyrë të plotë dhe të përmbledhur fizikën e përgjithshme nga njëra anë dhe nga ana tjetër, disa tema që trajtojnë shfaqjen e dukurive kryesore fizike në botën e gjallë. Të shkrira në mënyrë organike me përmbajtjen e fizikës së përgjithshme janë trajtuar disa dukuri kryesore të biofizikës si biomekanika, mekanika e fluideve në sistemet biologjik. Membranat dhe transporti i lëndës e nxehtësisë . Bioakustika, procesi i te parit, fotosinteza, rrezatimet jonizuese jo jonizuese.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	75 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>6 ETCS = 150orë</b>		
		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
Format e mësimdhënies	Leksione	4	45	45
	Ushtrime	2	30	30
	<b>Gjithsej</b>	<b>6</b>	<b>75</b>	<b>75</b>
Temat që do trajtojë lënda  45 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fizika dhe objekti i saj i studimit. Madhësitë fizike. Veprimet me vektorë. (1 orë)</li> <li>2. Kinematika. Pika materiale. Sistemi i referimit. Shpejtësia dhe nxitimi mesatar. (1 orë)</li> <li>3. Zhvendosja, shpejtësia, nxitimi dhe ekuacionet e lëvizjes për lëvizjen drejtvizore me nxitim konstant. Rënia e lirë e trupave. (1 orë)</li> <li>4. Lëvizja e lakuar. Vektorët e zhvendosjes, shpejtësisë dhe nxitimit. Lëvizja e trupit të hedhur në një kënd me horizontin. (1 orë)</li> <li>5. Inercia. Ligjet e Njutonit. Forca e rëndesës dhe pesha. Dinamika e lëvizjes së lakuar.(1 orë)</li> <li>6. Puna e kryer e një force konstante dhe te ndryshueshme. Fuqia. Energjia kinetike. Teorema e energjisë kinetike. (1 orë)</li> <li>7. Energjia potenciale. Forcat konservative dhe jokonservative. Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike.(1 orë)</li> <li>8. Pika materiale në levizje rrethore. Shpejtësia dhe xitimi këndor. Kinematika e lëvizjes rrotulluese. (1 orë)</li> <li>9. Momenti i inercisë. Momenti i një force dhe një çifti forcash. Kushte të ekuilibrit. Qendra e gravitetit. Levat. (1 orë)</li> <li>10. Ligji themelor i dinamikës së lëvizjes rrotulluese. Puna dhe energjia në lëvizjen rrotulluese. (1 orë)</li> <li>11. Ekuilibri në trupin e njeriut. Muskujt skeletor. Levat në trupin e njeriut. Shpina. Elasticiteti i materialeve biologjike. (1 orë)</li> <li>12. Impulsi dhe goditjet. Impulsi linear dhe ligji i ruajtjes së impulsit. Goditjet elastike dhe joelastike njëdimensionale. (1 orë) <b>Prvovimi P1</b></li> <li>13. Densiteti. Shtypja. Ligjet e hidrostatikës. Shtypja atmosferike. Matja e shtypjes. Sfigmanometri. Lëvizja e një lëngu ideal. (1 orë)</li> <li>14. Teorema e Bernulit. Lëvizja e lëngjeve realë. Ligji i Pazelit. Lëngjet njutonianë dhe jo njutonianë. Matja e viskozitetit. (1 orë)</li> <li>15. Tensioni sipërfaqësor. Formula e Laplasit. Forcat e kontaktit. Kapilariteti. Avullimi dhe kondesimi i lëngjeve. (1 orë)</li> <li>16. Presioni i gjakut dhe faktori hidrostatik. Viskoziteti i gjakut dhe pasojat e tij. (1 orë)</li> <li>17. Sistemi i qarkullimit të gjakut. Elasticiteti i enëve të gjakut. Rezistenca ndaj rrjedhjes e enëve të gjakut. (1 orë)</li> <li>18. Puna e zemrës. Kontrolli i rrymës së gjakut. Gjaku si lëng jo njutonian. Enët e gjakut si trupa absolutisht të ngurtë. (1 orë)</li> <li>19. Membranat biologjike. Përshkueshmëria dhe transporti i lëndës. Bazat fizike të frymëmanijes. (1 orë)</li> </ol>		

Emërtimi i lëndës	Kimia e Përgjithshme	KODI (KIM 143)
	<p>20. Ndërtimi i lëndës. Atomet dhe molekulat. Temperatura. Shkallët e temperaturës. (1 orë)</p> <p>21. Ekuacioni themelor. Ligjet eksperimentale të gazeve ideale. Ekuacioni i gjendjes së gazit ideal. (1 orë)</p> <p>22. Energjia e brendëshme e gazit ideal. Nxehtësia, Bumimi termik. Transmetimi i nxehtësisë. (1 orë)</p> <p>23. Puna në proceset termodinamike dhe Parimi i parë i termodinamikës. Zbatime të parimit të parë. (1 orë)</p> <p>24. Energjia e nevojshme për njeriun. Energjia prej ushqimit. Rregullimi i temperaturës së trupit. Avullimi i djersës. (1 orë)</p> <p>25. Nxehtësia specifike e gazeve. Parimi i dytë . Cikli Karno. Entalpia. Entropia. Konkluzione termodinamike mbi entropinë. (1 orë)</p> <p>26. Lekundjet harmonike. Ekuacioni i valës. Parimi i Hygensit. Pasqyrimi. Thyerja. Interferenca. Efekti Dopler. (1 orë)</p> <p>27. Natyra e dritës. Modeli i rrezes dritore në optikën gjeometrike. Parimi i Hygensit. Pasqyrimi dhe thyerja. Dioptri. (1 orë)</p> <p>28. Zbërthimi i dritës. Emetimi. Spektri i emetimit dhe absorbimit. Spektrofotometria. (1 orë)</p> <p>29. Pasqyrimi i plotë i brendshëm. Fibrat optike. Shëmbëllimet e formuara nga pasqyrat e rrafshët dhe lentet. (1 orë)</p> <p>30. Eksperimenti i Jungut me dy carje. Interferenca dhe difraksioni me valët e dritës. (1 orë) ) <b>Prvovimi P2</b></p> <p>31. Drita dhe te parët .Ndijimi i dritës. Procesi i të parit. Ngjyra e trupave. Përzierja e ngjyrave. Shpërhapja e dritës. Turbidimetria. (1 orë)</p> <p>32. Syri i njeriut. Defektet e të parit dhe korigjimi i tyre. Polanizimi. Polarimetria. Proceset fizike të fotosintezës. Pigmentet fotosintetikë. (1 orë)</p> <p>33. Mikroskopi i thjeshtë. Mikroskopia elektronike. (1 orë)</p> <p>34. Ngarkesave elektrike dhe fusha. Ligji i Kulonit. Lëvizja e grimcave të ngarkuara në një fushë elektrike të njëtrajtshme. Dipoli elektrik. (1 orë)</p> <p>35. Potenciali, diferenca e potencialeve e një fushë elektrike të njëtrajtshme. Energjia potenciale. Lidhja e fushës elektrike me potencialin elektrik.</p> <p>36. Kapaciteti dhe energjia e kondensatorëve të ngarkuar. Rryma elektrike. Rezistenca. <b>Fem</b> e burimeve. Lidhja e rezistencave në seri dhe paralel. (1 orë)</p> <p>37. Rryma e vazhduar. Ligji i Omit. Efekti i Xhaulit dhe termoelektrik. Elektroliza. (1 orë)</p> <p>38. Elektromagnetizmi. Përcjellësit me rrymë. Induksioni. Forca e Lorencit. Induksioni elektromagnetik. Autoinduksioni. (1 orë)</p> <p>39. Veprimi i elektricitetit mbi trupin e njeriut. Elektrofiziologjia e qelizave nervore. Potenciali elektrik i prehjes. (1 orë)</p> <p>40. Skema elektrike e njëvlerëshme e një membrane. Potencialet bioelektrik. Elektrofiziologjia e zemrës. (1 orë)</p> <p>41. Teoria korpuskulare e dritës. Efekti fotoelektrik. Struktura e atomit. Atomi i hidrogjenit. Rrezet X. (1 orë)</p> <p>42. Bashkëveprimet molekulare. Nivelet energjetike. Spektrat molekularë. Spektrofluorometria. (1 orë)</p> <p>43. Rrezatimet jo jonizuese. Efektet e rrezeve ultraviolet mbi molekulat, mikroorganizmat dhe njeriu. (1 orë)</p> <p>44. Ndërtimi i bërthamës. Radioaktiviteti natyral dhe artificial. Bashkëveprimi i rrezatimit me lëndën. (1 orë)</p> <p>45. Rrezatimet jonizuese në biologji. Dozimetria. Efektet e rrezatimeve në qeliza, indet dhe organizmat e gjallë. (1 orë) (<b>Provimi final</b>)</p>	

V iti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		<b>Disiplina të formimit karakterizues të programit</b>		
Përshkrimi		Lënda e Kimisë së Përgjithshme synon që t'u japë studentëve të Fakultetit të Shkencave Teknike njohuri bazë mbi lëndën, elementët dhe substancat kimike. Gjatë leksioneve dhe seminareve bëhet një rishikim më i avancuar i njohurive të marra në Shkollën e Mesme të Përgjithshme në lëndën e Kimisë, kurse për ata studentë që vijnë nga Shkollat e Mesme Profesionale synohen të jepen që në fillim dhe njohuritë bazë të Kimisë së Përgjithshme. Ky program synon të japë një formim të përgjithshëm për të interpretuar fenomenet kimike dhe për të thelluar njohuritë me karakter kimik që mund t'u paraqiten gjatë viteve të studimit dhe në aktivitetin e tyre profesional.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	125 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
Format e mësimdhënies	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik  45 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Historiku i Kimisë.</li> <li>2. Stekiometria. Teoria atomike e Daltonit. Masat atomike. Formulatat kimike. Moli. Nxjerrja e formulave kimike.</li> <li>3. Përbërja në përqindje e komponimeve. Barazimet kimike. Llogaritjet që bazohen në barazimet kimike.</li> <li>4. Stekiometria e reaksioneve në tretësira. Rendimenti i reaksionit kimik.</li> <li>5. Termokimia Njësitë e energjisë. Barazimet termokimike. Ligji i Hessit.</li> <li>6. Entalpija e formimit. Energji e lidhjeve.</li> <li>7. Ndertimi i atomit. Elektroni. Protoni. Neutroni. Atomi bërthamor. Simbolet atomike. Izotopet.</li> <li>8. Rrezatimi elektromagnetik. Spektrat atomike. Numri atomik dhe ligji periodik</li> <li>9. Mekanika valore Numrat kuantike.</li> <li>10. Mbushja e orbitaleve dhe rregulli i Hundit. Struktura elektronike e elementeve. Tipet e elementeve</li> <li>11. Vetitë e atomeve. Përmasat atomike. Energjitë e jonizimit. Afritë elektronike.</li> <li>12. Lidhja jonike. Energjia e rrjetes. Tipet e joneve. Rrezja jonike. Nomenklatura e komponimeve jonike.</li> <li>13. Lidhja kovalente Ngarkesa formale. Strukturat e Lewisit</li> <li>14. Rezonanca. Kalimi ndërmjet lidhjes jonike dhe kovalente. Elektronegativiteti. Nomenklatura e komponimeve binare kovalente.</li> <li>15. Gjeometria e molekulave Përjashtimi nga rregulli i oktetit. Shtytja e cifteve elektronike dhe gjeometria molekulare.</li> <li>16. Orbitalet hibride. Orbitalet molekulare. Orbitalet molekulare dhe molekulat dhe jonet me shumë atome. Lidhjet p-<math>\pi</math> dhe d-<math>\pi</math>.</li> <li>Leksioni 17. Gazet. Ligji i Bojlit. Ligji i Sharlit. Ligji i Amontonit. Ligji i gazit ideal.</li> <li>18. Teoria kinetike e gazeve. Përftimi i ligjit të gazit ideal nga teoria kinetike.</li> <li>19. Ligji i Gej-Lysakut për vëllimet e gazeve dhe parimi i Avogadros. Ligji i Daltonit për trysnitë pjesore. Ligji i Grahmit. Gazet reale.</li> <li>20. Lëngjet dhe trupat e ngurtë. Forcat e tërheqjes ndermolekulare. Lidhja hidrogjenore. Gjendja e lëngët.</li> <li>21. Avullimi. Trysnia e avullit. Pika e vlimit. Entalpia e avullimit. Lëngëzimi i gazeve.</li> <li>22. Trysnia e avullit e nje trupi të ngurtë. Pika e ngrirjes. Diagramat fazore.</li> <li>23. Llojet e trupave të ngurtë kristalore. Kristalet. Difraktimi i rrezeve</li> </ol>		

	<p>X në kristale. Kristalet jonike.</p> <p>24. Tretësirat. Natyra e tretësirave Procesi i tretjes. Entalpia e tretjes. Jonet e hidratuara. Përqëndrimi i tretësirave.</p> <p>25. Trysnia e avullit të tretësirave. Osmoza. Distilimi. Tretësirat e elektroliteve.</p> <p>26. Reaksionet në tretësira ujore. Reaksionet e këmbimit. Numrat e oksidimit. Reaksionet redoks. Oksidet acide dhe bazike. Emërtimi i acideve ,bazave dhe kriprave.</p> <p>27. Kinetika Shpejtësia e reaksioneve kimike. Përqëndrimet dhe shpejtësia e reaksioneve. Reaksionet me një stad. Ekuacionet e shpejtësisë për reaksionet me një stad.</p> <p>28. Mekanizmi i reaksioneve. Ekuacionet e shpejtësisë dhe temperatura. Kataliza.</p> <p>29. Ekuilibri kimik Reaksionet e prapësueshem dhe ekuilibri kimik. Konstantet e ekuilibrit. Konstantet e ekuilibrit të shprehura me anë të trysnive. Parimi Le-Shatellie.</p> <p>30. Acidet dhe bazat. Konceptet e Arheniusit. Pikpamjet e Brenshted-Llourit. Forca e acideve dhe bazave të Brenshtedit. Fortësia e acideve dhe struktura molekulare. Konceptet e Lwisit.</p> <p>31. Ekuilibrat jonike Elektrolitet e dobët. Shpërbashkimi i ujit. pH. Treguesit e ngjyrosur. Tretësirat tampon. Efekti i jonit të përbashkët. Jonet që sillen si acide ose si baza.</p> <p>32. Produkti i tretshmërisë. Precipitimi dhe prod. i tretshmërisë. Amfoterizimi.</p> <p>33. Termodinamika. Parimi i parë i termodinamikës. Entalpia. Parimi i dytë i termodinamikës. Energjitë e lira standarte. Entropite absolute.</p> <p>34. Energjia e lirë e Gibssit. Energjia e lirë e Gibssit dhe ekuilibri.</p> <p>35. Elektrokimia. Përcjellshmëria metalike. Përcjellshmeria elektrolitike. Elektroliza. Stekiometria e elektrolizës.</p> <p>36. Elementet galvanike Forca elektromotore. Potencialet elektrodike. Potencialet elektrodike dhe elektroliza</p> <p>37. Ndryshimi i energjisë së lirë të Gibssit dhe forca elektromotore. Ndikimi i përqëndrimit në potencialet elektrodike. Disa elemente galvanike të përdorimit të gjerë.</p> <p>38. Korrozioni i hekurit. Klasifikimi i korrozionit. Mbrojtja nga korrozioni.</p> <p>39. Metalet Lidhja metalike. Teoria e zonave. Gjysmë përcjellësit.</p> <p>40. Vetitë fizike të metaleve. Gjendja në natyrë e metaleve. Metalurgjia Trajtimi paraprak i xeheroreve. Reduktimi. Rafinimi</p> <p>41. Metalet e grupit I-Adhe II-A. Metalet e grupit të III-A dhe IV-A.</p> <p>42. Metalet Kalimtare. Lantanidet.</p> <p>43. Jo metalet. Përhapja dhe vetitë e hidrogjenit. Halogjenet. Vetitë e tyre. Përdorime industriale të halogjeneve.</p> <p>44. Vetitë e jometaleve të grupit të III-A IV-A. V-A Vetitë e elementeve të grupit të VI-A. Gazet e plogëta.</p> <p>45. Kimia bërthamore. Bërthama. Radioaktiviteti. Reaksionet bërthamore.</p>
--	---



Emërtimi i lëndës		KIMI ORGANIKE		KODI (KIM 255)
Viti		II		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplina të formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi		Lënda "Kimi Organike" ka për qëllim njohjen e studentit me lidhjet kimike, hibridizimet, përbërjet e ndryshme organike, si hidrokarburet alifatike dhe aromatike, stereokiminë e komponimeve të karbonit, halogjenurët organikë, etj.. Problematika e shqyrtuar do të ketë të bëjë me klasifikimin, emërtimin, përfitim dhe vetitë e klasave kryesore të komponimeve organike si: alkanet dhe cikloalkanet, alkenet, alkinet, halogjenurët e alkilit, benzenin dhe homologët e tij, alkoolet, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike e derivatat e tyre, etj.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	125 orë		
Kreditet		8 ETCS = 200 orë		
		Kredite (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
Format e mësimdhënies	Gjithsej	8	75	125
Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik  45 orë leksione		<p>1: Objekti dhe rëndësia e Kimisë Organike. Natyra e lidhjes kimike në Kiminë Organike. Lidhja kovalente, kovalente polare dhe lidhja kovalente e koordinuar. Orbitalet atomike, orbitalet molekulare dhe orbitalet hibride të karbonit. Hibritizimi i Karbonit.</p> <p>2: Faktorët që ndikojnë në reaktivitetin e molekulave organike, efekti induktiv, efekti mezomer, efekti sterik dhe hiperkonjugimi. Rezonanca dhe mezomeria.</p> <p>3: Mbi acidet dhe bazat organike. Tipet e reaksioneve organike. Nukleofilet dhe elektrofilët.</p> <p>4: Alkanet Struktura e alkaneve. Emërtimi, përfitimi i alkaneve. Vetitë e alkaneve dhe përfaqësuesit e tyre.</p> <p>5: Cikloalkanet. Përfitimi dhe vetitë e cikloalkaneve. Teoria e Bayerit për tensionin e ciklit.</p> <p>6: Konformacionet e alkaneve dhe cikloalkaneve. Analiza e konformacioneve të cikloheksanet e bizëvendësuar.</p> <p>7: Alkenet. Emërtimi i alkeneve. Izomeria gjeometrike e alkeneve. Përfitimi i tyre.</p> <p>8: Vetitë e alkeneve.</p> <p>9: Dienet dhe polienet. Struktura dhe emërtimi i dieneve. Sinteza e dieneve dhe reaksionet e tyre. Butadieni dhe vetitë e tij.</p> <p>10: Alkinet Emërtimi dhe struktura e alkineve. Përgatitja reaksionet dhe vetitë e tyre.</p> <p>11: Stereoizomeria. Aktiviteti optik. Konfiguracioni relativ dhe absolut. Sistemi (R) dhe (S) për emërtimin e izomerëve optik.</p> <p>12: Molekulat që përmbajnë më tepër se një atom kiral, diastomerët. Përbërjet mezo, stereoizomerët e acidit tartrik. Përzierjet racemike, ndarja e izomerëve optik në një përzierje racemike.</p> <p>13: Halogjenurët organike. Emërtimi i halogjenurëve. Përgatitja dhe vetitë e halogjenurëve.</p> <p>14: Reagentët Grignard dhe komponimet organometalike.</p> <p>15: Hidrokarburët aromatikë. Struktura e benzenit. Energjia rezonante e benzenit. Gjendja elektronike e benzenit. Karakteri aromatik, rregulla e Hykel.</p> <p>16: Emërtimi i derivateve të benzenit. Reaksionet e zëvendësimit elektrofilik.</p> <p>17: Efekti i orientuesve në reaksionet e zëvendësimit elektrofilik aromatik.</p> <p>18: Reaksionet e alkilbenzeneve. Hidrokarburet aromatike me cikle të kondensuara. Zëvendësimi nukleofilik aromatik.</p> <p>19: Alkoolet dhe Fenole. Emërtimi i alkooleve dhe fenoleve. Vetitë fizike të alkooleve. Aciditeti dhe baziciteti i alkooleve dhe fenoleve.</p> <p>20: Përgatitja dhe vetitë alkooleve dhe fenoleve.</p>		



21: Eteret. Emërtimi i etereve. Vetitë fizike të etereve. Përgatitja dhe reaksionet e etereve.

22: Epoksidet, eteret ciklike.

23: Aldehidet dhe ketonet. Emërtimi i aldehideve dhe ketoneve. Struktura e grupit karbonilik. Përgatitja e aldehideve dhe ketoneve.

24: Vetitë kimike të aldehideve dhe ketoneve

25: Oksidimi i karboneve karbonilike. Reaksione që ndodhin te karboni  $\alpha$ . Reaksione të tjera karakteristike të aldehideve dhe ketoneve

26: Acidet karboksilike. Emërtimi i acideve karboksilike. Vetitë fizike. Shpërbashkimi i acideve karboksilike. Ndikimi i zëvendësuesve në aciditetin e acideve.

27: Përgatitja e acideve karboksilike dhe vetitë e acideve karboksilike. Përfaqesues të acideve.

28: Derivate të acideve karboksilike. Halogjenurët dhe anhidridet e acideve karboksilike. Esteret , reaksionet e tyre (hidroliza, aminoliza) dhe amidet

29: Nitrilet dhe izonitrilet. Përgatitja dhe reaksionet e tyre.

30: Acidet dikarboksilike, hidroksiacidet dhe ketoacidet.

31: Aminat. Klasifikimi dhe strukturat e aminave. Emërtimi i aminave. Vetitë fizike. Baziciteti i aminave

32: Përgatitja dhe reaksionet e aminave dhe arilaminave. Bashkëveprimi me acidin nitror. Kopulimi i kriprave të diazoniumit.

33: Nitrokomponimet. Përgatitja dhe vetitë e tyre.

34: Karbohidratet. Kiraliteti në monosaharidet. Projektionet e Fisherit. Sheqernat D, L. Strukturat semiacetalike ciklike të monosaharideve. Format anomere të monosaharideve. Fenomeni i mutarrotacionit.

35: Reaksionet e monosaharideve

36: Disaharidet dhe polisaharidet

37: Aminoacidet. Klasifikimi i aminoacideve. Vetitë acido-bazike të aminoacideve. Përgatitja dhe vetitë kimike të aminoacideve.

38: Peptidet dhe proteinat. Strukturat primare, sekondare, terciare dhe kuaternare. Denatyrimi i proteinave

39: Komponimet heterociklike. Lidhjet dhe baziciteti i piridinës. Reaksionet e zëvendësimit të piridinës.

40: Heteroatomet pentaatomike. Furani, piroli dhe Tiofeni, azolet. Heterociklet pentaatomike me cikle të kondesuara. Indolet, Purinat.

41: Lipidet. Emërtimi dhe klasifikimi i acideve yndyrore. Vetitë fizike dhe kimike të acideve yndyrore.

42: Lipidet e thjeshtë e të përbërë. Gliceridet. Dyllrat dhe steridet

43: Fosfolipidet. Glikolipidet. Terpenet. Sapunet dhe detergjentet

44: Acidet nukleike. Përbërja e acideve nukleike. Nukleozidet dhe nukleotidet. Polinukleotidet. ADN.

45: Përsëritje

Emërtimi i lëndës		Biologji qelizore		KODI (BIO 163)
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Lëndë të detyrueshme/Disiplina të formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi		<p>Në këtë lëndë synohet të trajtohet organizimi morfologjik dhe funksional i qelizave prokariote dhe eukariote, ndërtimi dhe funksioni i membranës qelizore, sistemi i brendshëm membranor (rrjeti endoplazmatik dhe aparati Golxhi), citoskeleti dhe organelet qelizore si bërthama, mitokondritë, kloroplastet, ribozomet dhe lizozomet. Një vështrim i përgjithshëm do të drejtohet gjithashtu energjitikës qelizore, në veçanti proceseve të frymëkëmbimit qelizor dhe fotosintezës. Do të shqyrtohen proceset e replikimit dhe transkriptimit të mbartësve dhe transmetuesve të informacionit gjenetik (ADN), sintezës së proteinave si dhe mekanizmat bazë të kontrollit të shprehjes së gjeneve. Së fundi do të trajtohen aspektet kryesore që karakterizojnë procese me rëndësi të veçantë si sinjalizimi brendaqelizor, cikli qelizor dhe mekanika e ndarjes qelizore.</p>		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	125 orë		
Kreditet		8 ETCS = 200 orë		
		Kredite (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
Format e mësimdhënies	Gjithësej	8	75	125
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik		<p>46. Hyrje në Biologjinë qelizore. Nga prokariotët tek eukariotët. Pema e jetës dhe organizimi i qelizës prokariote. (1 orë)</p> <p>47. Diversiteti biokimik ndërmjet qelizave prokariote. Qelizat eukariotike dhe prejardhja e organeleve të tyre. (1 orë)</p> <p>48. Teknika në Biologjinë qelizore dhe Molekulare. Mikroskopia fluoeshente. Mikroskopi fazë-kontrast. Mikroskopia elektronike. (1 orë)</p> <p>49. Teknologjia e ADN-së rekombinante. Struktura dhe përbërja kimike e membranës plazmatike. Një historik i shkurtër i studimit të membranës plazmatike. Lipidet membranore. (1 orë)</p> <p>50. Ruajtja e fluiditetit të membranës. Asimetria e lipideve membranore. Karbohidratet dhe proteinat membranore. (1 orë)</p> <p>51. Zonat e specializuara të membranës plazmatike. Polariteti i qelizave. (1 orë)</p> <p>52. Matriksi jashtëqelizor. Ndërveprimi i qelizave me substratin jashtëqelizor. Ndërveprimi i qelizave mes tyre. (1 orë)</p> <p>53. Transporti membranor. Transporti pasiv. Transporti aktiv dhe sistemet pompa. (1 orë)</p> <p>54. Kotransporti i ndërmjetësuar nga sisteme simporter dhe antiporter. Osmoza. Fagocitoza dhe endocitoza. (1 orë)</p>		
45 orë leksione				

	<p>55. Qeliza nervore dhe potenciali membranor. Kanalet jonike përmes membranës. (1 orë)</p> <p>56. Potenciali i qetësisë. Potenciali i veprimtimit. (1 orë)</p> <p>57. Sinapset dhe transmetimi i impulsit nervor. Receptorët dhe llojet e neurotransmetuesve që lidhen me ta. (1 orë)</p> <p>58. Sistemi membranor i brendshëm. Rrjeti endoplazmatik. (1 orë)</p> <p>59. Aparati Golxhi. Glikozilimi i proteinave. (1 orë)</p> <p>60. Tipat e vezikulave të transportit dhe funksioni i tyre. Lizozomet. (1 orë)</p> <p>61. Mitokondritë dhe frymëmarrja qelizore. Një vështrim i përgjithshëm i energjetikës qelizore. (1 orë)</p> <p>62. Struktura dhe funksioni i mitokondrive. (1 orë)</p> <p>63. Rrugët e metabolizmit të glukozës. Peroksidomet. (1 orë)</p> <p>64. Kloroplastet dhe fotosinteza. Struktura dhe funksioni i kloroplasteve. (1 orë)</p> <p>65. Analiza molekulare e fotosintezës tek bimët. (1 orë)</p> <p>66. Citoskeleti dhe lëvizja qelizore. Një vështrim i përgjithshëm i funksioneve më të rëndësishme të citoskeletit. Filamentet e ndërmjetme. (1 orë)</p> <p>67. Mikrogythat. Cilet dhe flagjelët. Filamentet e aktinës dhe proteinat që bashkëveprojnë me to. (1 orë)</p> <p>68. Muskuli, një makineri tkurrëse e specializuar. (1 orë)</p> <p>69. Sinjalizimi qelizor. Parimet bazë të komunikimit qelizor. (1 orë)</p> <p>70. Receptorët e çiftuar me proteinën G. Mesazherët sekondarë. (1 orë)</p> <p>71. Receptorët tirozinë-kinazikë. Bërthama qelizore. Një vështrim i përgjithshëm i strukturës dhe funksionit të bërthamës. (1 orë)</p> <p>72. Mbështjella bërthamore dhe komplekset porike. Organizmi molekular i ADN-së në kromozome. (1 orë)</p> <p>73. Morfologjia dhe karakteristikat funksionale të kromozomeve eukariotikë. Nukleolet. (1 orë)</p> <p>74. Struktura dhe sinteza e acideve nukleike. Polimerizimi i nukleotideve prodhon acide nukleike. Acidet dezoksiribonukleike dhe ribonukleike. (1 orë)</p> <p>75. Dyfishimi i ADN-së është gjysëmkonservativ. Dyfishimi i ADN-së në qelizën prokariote. (1 orë)</p> <p>76. Dyfishimi i ADN-së në qelizën eukariote. (1 orë)</p> <p>77. Sinteza e ARN-ve dhe proteinave. Një vështrim i përgjithshëm i sintezës së proteinave. Funksionet e të tre llojeve të ARN-ve. (1 orë)</p> <p>78. Kodi gjenetik. Proçesi i kopjimit të ADN-së. (1 orë)</p> <p>79. Mekanizmat e molekulare të inicimit të transkriptimit tek bakteret dhe eukariotët. (1 orë)</p> <p>80. Maturimi i ARN-ve mesazhere tek eukariotët. Transporti i mRNA-ve bërthamore në citoplazëm. (1 orë)</p> <p>81. Maturimi i r-ARN-ve dhe t-ARN-ve. (1 orë)</p> <p>82. Translatimi. (1 orë)</p> <p>83. Kontrolli i shprehjes së gjeneve. Kontrolli i shprehjes së gjeneve tek prokariotët. (1 orë)</p> <p>84. Kontrolli i shprehjes së gjeneve tek eukariotët. (1 orë)</p> <p>85. Mekanizmat që rregullojnë ciklin e ndarjes qelizore. Strategjia e përgjithshme e ciklit qelizor. (1 orë)</p>
--	---

	<p>86. Makineria molekulare e kontrollit të ciklit qelizor. (1 orë)</p> <p>87. Kontrolli i ndarjes qelizore tek gjitarët. Kontrolli jashtëqelizor i ndarjes dhe rritjes qelizore. (1 orë)</p> <p>88. Gjenet që kontrollojnë proliferimin qelizor. Një vështrim i përgjithshëm i fazëm M. (1 orë)</p> <p>44-45. Mitoza dhe Mejoza në qelizat eukariote. Citokineza. (2 orë)</p>
--	--

<i>Emërtimi i lëndës</i>		<b>Botanikë e përgjithshme</b>		<b>KODI (Bio160)</b>
<i>Viti</i>		I		
<i>Semestri</i>		II		
<i>Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit</i>		<b>Lëndë të detyrueshme/Disiplina të formimit karakterizues të programit</b>		
<i>Përshkrimi</i>		<p>Lënda e Botanikës së Përgjithshme jep një formim të fushës studimore të Botanikës. Temat që do të trajtohen kanë të bëjnë me citologjinë, anatominë dhe morfologjinë bimore. Gjatë kësaj lënde do të bëhet një hyrje e shkurtër për bimët, jetën, përbërjen kimike të bimës, qelizat eukariote dhe ato prokariote. Më pas do të bëhet një hyrje në citologjinë bimore e cila do të thellohet me shumë në tema të tjera të librit. Do të trajtohen organelat e qelizës bimore, indet bimore përbërja e tyre dhe funksioni. Temat si anatomia dhe morfologjia e pjesëve ndërtuese të bimës do të jenë pjesë e programit të Botanikës së Përgjithshme.</p> <p>Do të merren njohuri themelore për riprodhimin bimor, anatominë dhe morfologjinë e organelave riprodhuese tek bima. Programi do të mbyllet me njohuri bazë në fushën e biologjisë së zhvillimit dhe në fushën e Bioteknologjisë Bimore.</p>		
<i>Ngarkesa në orë</i>		<i>Në auditore</i>		
		95 orë		
		<i>Jashtë auditorit</i>		
		105 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
<i>Format e mësimdhënies</i>	<b>Gjithësej</b>	<b>8</b>	<b>95</b>	<b>105</b>
<i>Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik</i>		<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Hyrje në botanikë. Objekti dhe fushat studimore botanike. Rëndësia e bimëve në natyrë. Bimët dhe kafshët. (1 orë)</li> <li>2.Përbërja kimike e bimëve. Elementët e domosdoshëm. Bimët dhe uji.Makromolekulat biologjike. Acidet bërthamore. Proteinat biologjike. Karbohidratet. Yndyrnat. (1 orë)</li> <li>3.Qeliza eukariote bimore. Format dhe përshkrimi përmbledhës i qelizës bimore. Muri qelizor, Protoplasti. Sistemi membranor dhe funksioni i membranave. (1 orë)</li> <li>4.Citoplazma dhe bërthama. Sistemi vakular dhe lëngu qelizor, plastet dhe fotosinteza. Mitokondritë dhe frymemarrja, diktiomet dhe aparat i Golxhit. (1 orë)</li> <li>5.Lisozomet, ribozomet dhe citoskeleti. Centriolet, flagjeli dhe ciliet. Qelizat e kërpudhave. (1 orë)</li> <li>6.Qeliza prokariote, arket, viruset dhe prionet. Ndërtimi dhe fotosinteza tek qeliza prokariote, si dhe gjallesat me qelizë prokariote. (1 orë)</li> <li>7.Bërthama. Rëndësia dhe ndërtimi i bërthamës. Mejoza, mitoza dhe fekondimi. (1 orë)</li> <li>8.Plastet diferencimi i tyre dhe pigmentet fotosintetike. (1 orë)</li> <li>9.Funksioni i kloroplasteve - fotosinteza. Plastet e tjera të bimëve. Amidoni dhe lëndë të tjera rezervë. (1 orë)</li> <li>10.Vakuola- lëngu qelizor. Formimi dhe funksionet e vakuolës. Përbërësit e lëngut qelizor. (1 orë)</li> <li>11. Muri dhe membrana qelizore. Rëndësia e murit qelizor dhe fillesa e tij.Muri qelizor parësor dhe plazmodezmat. (1 orë)</li> <li>12.Meatet dhe lakunat. Muri qelizor dytësor. Persoja e</li> </ol>		
42 orë leksione				

	<p>mureve qelizore dhe shperbërja e tij. (1 orë)</p> <p>13.Hyrje në Histologjinë bimore. Indet bimore meristemmatike, parësore dhe dytësore. (1 orë)</p> <p>14.Indi e rritur - Parenkimat. Indet e mbulimit- Epiderma dhe tapa. (1 orë)</p> <p>15.Ndërtimi i gojëzave, funksionimi dhe formimi i tyre.Qimet mbuluese dhe emergjencat. Tapa dhe thjerrëzat. (1 orë)</p> <p>16.Indet mbështetëse-Kolenkima dhe sklerenkima. (1 orë)</p> <p>17.Indet përçuese floema, ksilema dhe tufat përçuese. (1 orë)</p> <p>18.Indet pronditëse. Lëndët e pronditjes. Elementët pronditës të jashtëm dhe të brëndshëm. Enët qumështore. (1 orë)</p> <p>19.Organizimi morfologjik i bimëve. Evolucioni morfologjik i bimëve. Protofitet, tallofitet, briofitet, kromofitet. Organet homologe dhe analoge. (1 orë)</p> <p>20.Organet rudimentare, atavizmat. Njohuri mbi rritjen dhe diferencimin bimor. (1 orë)</p> <p>21.Rrënja, forma dhe funksioni. Sistemi rrënjor tek bimët. Rrënjët mitake. Rrënja parësore në prerje gjatësore. (1 orë)</p> <p>22.Ndërtimi i parë anatomik i rrënjës. Rrënja e pteridofiteve dhe rrenja ajrore. Formimi i rrënjelave. (1 orë)</p> <p>23.Kalimi i tufave përçuese nga rrënja tek kërcelli. Ndërtimi i dytë anatomik tek rrënja. Formacionet dytësore rrënjore. Rrënjët, mikorizat dhe fiksimi i azotit atmosferik. (1 orë)</p> <p>24.Morfologjia e kërcellit. Kërcellthi i filizit. Llojet e sythave. Paragjethëzimi. Bisku. Degëzimi i kërcellit. (1 orë)</p> <p>25. Koni vegjetativ i kërcellit. Ndërtimi i parë anatomik i kërcellit tek gjimnospermet, dikotiledonet dhe monokotiledonet. Kalimi i tufave përçuese nga kërcelli në gjethe. (1 orë)</p> <p>26.Ndërtimi i dytë anatomik i kërcellit tek drurët. Kambiumi dhe felogjeni. Sistemet e tufave përçuese tek drurët. Rrathët vjetorë. (1 orë)</p> <p>27.Zemra e drurit. Floema e dytë dhe lëvorja e drurëve. Formacionet e dyta në kërcellin e monokoteve. (1 orë)</p> <p>28.Morfologjia e gjethes. Formimi i gjetheve. Gjethet e thjeshta dhe të përbëra. Morfologjia e gjetheve të thjeshta. (1 orë)</p> <p>29.Morfologjia e gjetheve të përbëra. Tipet e gjetheve dhe heterofilia.vendosja e gjetheve përgjatë kërcellit.jetëgjatësia e gjethes. (1 orë)</p> <p>30.Anatomia e gjethes dhe diferencimi i saj. Ndërtimi anatomik i bishtit dhe i llapës gjethore tek angjiospermët. (1 orë)</p> <p>31.Llojet e ndryshme të gjethes.Anatomia e gjethes tek gjimnospermët. Rënia e gjethes. Metamorfozat bimore. (1 orë)</p> <p>32.Përshtatja e bimëve ndaj stresit ujqor,barëngrënësve dhe sëmundjeve. Përshtatja e bimës ndaj temperaturës. (1 orë)</p> <p>33. Përshtatja e bimës ndaj ndriçimit dhe hapësirës. Përshtatja e mënyrës ushqyese. (1 orë)</p> <p>34.Njohuri mbi riprodhimin e bimëve. Riprodhimi seksual dhe aseksual. Mënyrat e riprodhimit aseksual. (1 orë)</p> <p>35.Mënyrat e riprodhimit seksual. Ciklet jetësore tek bimët dhe këmbimi i brezave. (1 orë)</p> <p>36.Riprodhimi seksual i bimëve me lule. Cikli jetësor i bimëve me lule. Rrethlulja: kupa dhe kurora. (1 orë)</p> <p>37.Ndërtimi i androceut dhe i kokrizës së pjalmmit.Ndërtimi i gineceut dhe ovulit. (1 orë)</p> <p>38.Diagrami dhe formula e lules. Lulesa dhe rëndësia e tyre. Mikrogametogjeneza. Megagametogjeneza. (1 orë)</p> <p>39.Pjalmimi, pllenimi ose fekondimi. (1 orë)</p>
--	--

	<p>40.Embrioni dhe zhvillimi i farës. Agamospermia. Zhvillimi , shpërndarja dhe klasifikimi i fryteve. (1 orë)</p> <p>41.Cikli jetësor i bimëve. Embriogjeneza. Mbirja e farave, faza vegetative dhe totipotenca. Faza riprodhuese. Plakja dhe seneshenca. (1 orë)</p> <p>42.Bioteknologjia bimore. (1 orë)</p>
--	---

Emërtimi i lëndës		Histologji		KODI (262)
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		<b>Lëndë të detyrueshme. Disiplina e formimit karakterizues të programit.</b>		
Përshkrimi		<p>Pëmes këtij programi synohet pajisja e studentëve me njohuritë bazë mbi metodat dhe objektin e lëndës së histologjisë, organizimin struktural dhe funksional të këtyre indeve kryesore (epitelial, lidhor, muskolor dhe nervor). Studentët do të njihen me arkitekturën tipike të indeve në organet dhe sistemet kryesore të organizmit duke u ndalur edhe në analizimin e funksioneve më të rëndësishme të diferencimit qelizor (sekretimi gjendror, tejçimi i impulsit nervor etj). Krahas teksteve të këshilluara, leksionet do të shoqërohen me material mësimor ndihmës të projektuar në sallë që do të jetë i disponueshëm për studentët. Do të organizohen gjithashtu leksione teoriko-praktike gjatë të cilave studentëve do tu kërkohet të diskutojnë mbi temat dhe fotografitë mikroskopike të leksioneve. Njëkohësisht gjatë seminareve studentët do të mund të vërojnë në mënyrë të pavarur indet kryesore nëpërmjet mikroskopit optik në mënyrë që të krijojnë një imazh konkret të objektit të lëndës së histologjisë.</p>		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	100 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>7 ETCS = 175 orë</b>		
		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
Format e mësimdhënies				
	<b>Gjithësej</b>	<b>7</b>	<b>75</b>	<b>100</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik 46 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> <li>Histologjia dhe metodat e studimit. Hyrje në Histologji. Organizimi struktural dhe funksional. Karakteristikat e jetës. Përgatitja e indeve. Mikroskopi optik. Histokimia dhe Citokimia. (1 orë)</li> <li>Metodat e përcaktimit duke përdorur ndërveprimet e afinitetit të lartë midis molekulave. Qelizat prokariote dhe eukariote. (1 orë)</li> <li>Diferencimi dhe Ekologjia qelizore. Kulturat indore. Kulturat primare. Linjat qelizore dhe shtamet qelizore. (1 orë)</li> <li>Indi epitelial. Veçoritë e indit epitelial. Specializimet e sipërfaqes qelizore. Tipet e qelizave – Epiteli mbulues. Epiteli gjëndror. (1 orë)</li> <li>Biologjia e indit epitelial. Elementët e indit lidhor. Lënda bazale. Qelizat e indit lidhor. Fibrat e kolagjenit-sinteza. (1 orë)</li> <li>Biosinteza e tipit të parë të kolagjenit. Tipat e indit lidhor. Indi lidhor i vërtetë. Indi elastik dhe retikular. Indi dhjamor. (1 orë)</li> <li>Indi dhjamor kafë. Indi mukoz. Kërcki dhe kocka. Kërcki hialin. (1 orë)</li> <li>Kërcki elastik dhe fijor. Kocka. Qelizat e kockës. Matriksi i kockës. (1 orë)</li> <li>Periosti dhe endosti. Tipat e kockës. Histogjeneza. Rritja dhe rimodelimi i kockës. (1 orë)</li> </ol>		



